

Revista: PROFESIONISTËT E SHËNDETIT

UDHËZUES PËR AUTORËT

Revista Profesionistët e Shëndetit është një revistë shkencore, periodike, që boton punime shkencore cilësore në të gjitha fushat e zhvillimit të njohurive për Profesionistët e Kujdesit Shëndetësor në Shqipëri, duke përfshirë profesionistët Infermier, mami, fizioterapeut, logopedë, teknikët e laboratorit dhe teknikët e imazherisë.

Botimet e kësaj reviste vijnë me qëllim promovimin e zhvillimit të kulturës profesionale, përditësimin me njohuritë e reja, shkëmbimin e eksperiencave profesionale për përmirësimin e cilësisë së kujdesjeve të ofruara nga këta profesionist.

Frekuenca: 1-2 herë në vit

Artikujt duhet të dërgohen në adresën e emailit (uish_albania@yahoo.com) ose në adresën e revistës së UISH uishrevista@gmail.com

Informacione për botuesit

Punimet shkencore mund të jenë studime kualitative, kuantitative ose të përziera, të përshtatura sipas përmbajtjes së një punimi shkencor.

Mund të jenë materiale profesionale edukuese (sensibilizuese), studime rasti, analiza ose rishikime të literaturës ku mund të diskutohen modele, teori, apo koncepte profesionale sipas fushave përkatëse.

Autorët janë përgjegjës për anën shkencore të materialeve që paraqesin dhe për redaktimin gjuhësor të tekstit. Gjuha duhet të jetë konform rregullave, sikurse kërkohet për artikujt shkencor. Konkluzionet duhet të dalin nga rezultatet e studimit. Nuk lejohet plagjiatura dhe do të raportohet autorit në rast se konstatohet.

Artikulli pas dërgimit do të kalojë në procesin e vlerësimit. Procesi i vlerësimit do të zgjasë të paktën 1 muaj. Do të pranohen vetëm artikujt e saktë dhe të plotë.

Autori përgjegjës informohet nga bordi shkencor kur artikulli ka nevojë për përmirësime ose plotësime të mëtejshme. Artikulli nuk ka tarifë për paraqitje dhe nuk ka asnjë tarifë për publikim.

Struktura e punimit shkencor:

- Formatimi në **format A4, në Word**, shkrimi i punimit duhet të jetë **Times New Roman** me **font 10**.
- Titulli duhet me **shkronja KAPITALE me font 12** dhe me **bold**. Titulli, autori(-ët), adresat vendosen **në qendër**.
- Emri mbiemri i autorit/ëve duhet të shkruhen me Font **12 Bold**.
- Përkatësitë e autorit/ëve duhet të shkruhen me font 10 dhe *Italic*.
- Artikulli mund të ketë deri në 6000 fjalë.

Artikulli duhet të përmbajë këto nënndarje:

- **Titullin**,
- **Autorin** (-ët) dhe kontaktet (Adresën(-at) përkatëse profesionale përfshirë e-mail, si dhe *kush mban lidhjet me Redaksinë*) në rreshta të veçantë
- **Abstrakti** (maksimumi 300 fjalë)
- **Fjalët kyçe** (deri në 5-6 fjalë)
- **Hyrja** (rishikim i literaturës dhe të dhëna)
- **Metodologjia**
- **Rezultatet**
- **Diskutimet**
- **Konkluzionet**
- **Lista e referencave/Bibliografia**

Nga ana gramatikore kërkohet që të gjitha tekstet duhet të jenë të shkruara me gjerat “ë” dhe “ç” të alfabetit, pa gabime ortografike, hapësirat midis fjalëve vendosen gjithmonë pas shenjave të pikësimit dhe jo para tyre.

Citimet e literaturës duhet të bëhen duke përdorur emrin e autorit/autorëve, vitin e botimit, titullin e plotë, shtëpia botuese dhe faqet, me font 10, si më poshtë:

1. Williams, F., Muirhead, N., & Pariente, C. (2020). Covid-19 and chronic fatigue. *BMJ (Clinical research ed.)*, 370, m2922. <https://doi.org/10.1136/bmj.m2922>
2. Sagherian, K., Steege, L. M., Cobb, S. J., & Cho, H. (2020). Insomnia, fatigue and psychosocial well-being during COVID-19 pandemic: A cross-sectional survey of hospital nursing staff in the United States. *Journal of clinical nursing*, 10.1111/jocn.15566. Advance online publication. <https://doi.org/10.1111/jocn.15566>
3. WHO. *Living guidance for clinical management of COVID-19: living guidance*, 23 November 2021. World Health Organization, Available online at: <https://www.who.int/publications/i/item/WHO-2019-nCoV-clinical-2021-2> (2021).

Shkarko modelin ne word.